

# Azilkërkuesit në Shqipëri

## Viti 2023


**Tiranë, më 04 korrik 2024:** Referuar Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në vitin 2023, rezultojnë 261 azilkërkues, duke shënuar një rritje, krahasuar me një vit më parë, ku kishim 125 azilkërkues. Azilkërkuesit me origjinë nga Afganistani zënë 61,7 % të azilkërkuesve gjithsej dhe rezultojnë 161 persona.

## Azilkërkuesit në Shqipëri

Duke analizuar vendin e origjinës së azilkërkuesve, vërehet se numri më i lartë i azilkërkuesve është me origjinë nga Afganistani me 161 azilkërkues, duke vijuar me 38 azilkërkues nga Siria dhe 25 azilkërkues nga Iraku.

Gjatë vitit 2023 rezultojnë 14 vendime pozitive për dhënie të statusit të mbrojtjes plotësuese për azilkërkuesit, nga këto raste 5 i përkasin shtetasve me origjinë nga Iraku, 4 i përkasin shtetasve me origjinë nga Afganistani dhe pjesa mbetur i përkasin shtetasve nga Siria dhe Palestina.

Fig. 1: Azilkërkuesit sipas vendeve kryesore të origjinës, 2023




*Burimi:* Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Për publikim 04 korrik 2024

Duke parë kërkesat për azil sipas muajve, muajt me më shumë aplikime kanë qenë Marsi, Shtatori dhe Tetori të cilët përbëjnë 46,0 % të aplikimeve gjithsej.

**Fig. 2: Kërkesat për azil sipas muajve, 2023**



*Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*

**Fitimi dhe lënia e shtetësisë Shqiptare**

Në vitin 2023 rezultojnë 1.382 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke shënuar rënie me 9,5 %, krahasuar me vitin 2022. Po të analizojmë të dhënat sipas gjinisë, vëmë re se 796 janë meshkuj dhe 586 femra.

Në 2023 rezultojnë 870 persona të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, duke shënuar një rritje me 20,7 %, krahasuar me vitin 2022. Nga këto të dhëna vihet re një dominim i femrave me 53,2% kundrejt 46,8 % e meshkujve që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare.


**Tab. 1: Fitimi dhe lënia e shtetësisë Shqiptare**

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Fitim shtetësie	316	345	485	423	711	1.527	1.382
Lënie shtetësie	651	640	741	513	724	721	870

*Burimi: Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë, Ministria e Brendshme*

Duke analizuar vendin e origjinës të personave që kanë fituar shtetësinë Shqiptare, vërehet se 74,7 % e përbëjnë ato me origjinë nga Kosova, 7,2 % me origjinë nga Turqia dhe 4,1 % me origjinë nga Siria.


**Fig. 3: Fitimi i shtetësisë Shqiptare sipas vendit të origjinës**



*Burimi: Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë, Ministria e Brendshme*

Gjatë 2023, 30,3 % e personave që kanë fituar shtetësinë Shqiptare i përkasin grup-moshës 30-39 vjeç, e ndjekur nga grup-mosha 40-49 vjeç dhe 20-29 vjeç, respektivisht me 24,0 % dhe 16,2 %. Për personat që kanë lënë shtetësinë Shqiptare, grup-mosha që dominon është 30-39 vjeç me 45,2 %, e ndjekur me grup-moshën 20-29 vjeç dhe 40-49 vjeç respektivisht me 20,7 % dhe 19,5 %.

**Fig. 4: Fitimi dhe lënia e shtetësisë Shqiptare sipas grupmoshës**



*Burimi: Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë, Ministria e Brendshme*

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit vjetor për azilkërkuesit në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve për azilkërkuesit në Shqipëri sipas gjinisë, muajit të aplikimit, vendeve të origjinës, si dhe numrin e individëve që kanë marrë dhe lënë shtetësinë Shqiptare.

Të dhënat mbi Azilkërkuesit dhe fitimit ose lënies së shtetësisë në Shqipëri sigurohen nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Politikave për Azilin, Të Huajt dhe Shtetësinë në Ministrinë e Brendshme.

## **Përkufizime:**

**Azil** është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese.

**Azilkërkues** është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë.

**Aplikim për azil** është kërkesa zyrtare e të huajit ose personit pa shtetësi para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas Konventës së Gjenevës së OKB-së, "Mbi statusin e refugjatit". Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përveç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.

**Kërkesë për azil** është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdo lloji mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente, në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjisllacionit shqiptar.

**Shtetësia shqiptare** fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat ligjore për shtetësinë shqiptare, të cilat respektojnë normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

**Shtetësia shqiptare fitohet** me: a) lindje; b) natyralizim; c) birësim

**Fitimi e shtetësisë** fitohet nga një i huaj që ka paraqitur kërkesë për marrjen e shtetësisë shqiptare, në rast se plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

**Lënia e shtetësisë shqiptare** nënkupton se pasja e shtetësisë shqiptare merr fund sipas kërkesës së personit, kur ai plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

**Shtetas i huaj** është personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe ka shtetësi të huaj.

**Person pa shtetësi** është personi që nuk gëzon shtetësinë e asnjë shteti për shkak të mungesës së një lidhjeje të qëndrueshme juridike ndërmjet tij dhe një shteti.

**Refugjat** është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës.

**Shtet apo vend i origjinës** është shteti, shtetësinë e të cilit mban kërkuesi ose në rastin e personave pa shtetësi, vendbanimi i zakonshëm i mëparshëm.

**Status i mbrojtjes plotësuese** është njohja në Republikën e Shqipërisë e të huajit ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese.

**Status i refugjatit** është njohja në Republikën e Shqipërisë e shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat.